

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA
"EMARA HOTEL" SHPK

Sot ne daten 14/02/2024, ne ortaket themelues :

KLORELA MYFTIU, e datelindjes 02/06/1984, lindur ne Kavaje, Shqiperi, banues ne Kavaje, e pajisur me leternjoftimin me nr.personal I45602107U,

YLLI MYFTIU, i datelindjes 04/06/1972, lindur ne Kavaje, Shqiperi, banues ne Kavaje, i pajisur me leternjoftimin me nr.personal H20604038R,

Ne baze te ligjit nr . 9901 date 14.04.2008 'Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ' dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 'Per qendren kombetare te regjistrimit ' kemi vendosur te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "EMARA HOTEL" SHPK.

Neni 1 :

Emertimi i shoqerise

Shoqeria do te quhet "EMARA HOTEL" SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti , ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si edhe ligjit per QKR.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Shoqeria do te kete seline e saj ne Karpen,Nr pasurie 80/1, Zona Kadastrale 2099. Shoqeria mund te krijoje dege , filiale , zyra përfaqësim ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj: Aktivitet ne fushen e hoteleri-turizem.

Neni 4

Kapitali i shoqërisë

Kapitali i shoqërisë "EMARA HOTEL" Shpk do të jetë 100.000 Leke .

Ky kapital përbehet nga 2 kuota dhe zotërohet në masën 50% nga ortakët KLORELA MYFTIU dhe 50% nga ortakët YLLI MYFTIU.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të përcaktuar .

Neni 6

Organet e shoqërisë

1.Asambleja e përgjithshme

2.Administratori

Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimin e statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar.
- Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese.
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

ADMINISTRATORI

Administrator i shoqerise do te jete Znj. KLORELA MYFTIU, e datelindjes 02/06/1984, lindur ne Kavaje, Shqiperi, banues ne Kavaje, e pajisur me leternjoftimin me nr.personal I45602107U i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte ripertitje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne do moment nga asambleja, me shumice te thjeshte te votave, me kusht qe ne mbledhje të marrin pjesë ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtone apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shperndarja e fitimit vjetor të shoqerise

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakëve pjesën e fitimit ne raport me vleren e kapitalit të regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8

Prishja e shoqerise.

Shoqeria priset :

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b)me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- ç)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723 date 3.5.2007 per "OKR",
- d) me vendim te gjykates,
- dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

NENI 9

Likuidimi I shoqerise.

Ne rast te likuidimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likuidator, I cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likuidimit.

Me vendimin e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likuidatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here kete njoftim, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10


Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershohet pas cregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

KLORELA MYFTIU



YLLI MYFTIU

